



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:048398

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05874217

KPPP.nr.334/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbare të kreditorit Kompania Regjionale Ujësjiellësi "Prishtina" SH. A, me seli në Prishtinë, rruga "Hazir Shala" Nr.4, kundër debitorit Sh.B. -Matex, me seli në Prishtinë, rruga "Llapit" AH-0320, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbareimor P.nr.67/2021 të datës 22.01.2021 të Përmbareuesit Privat Arsim Bajraktari, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 28.06.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Sh.B. -Matex, dhe ANULOHET Urdhri Përmbareimor P.nr.67/2021 i datës 22.01.2021, i lejuar nga Përmbareuesi Privat Arsim Bajraktari.

A r s y e t i m

Përmbareuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania Regjionale Ujësjiellësi "Prishtina" Sh. A, me seli në Prishtinë, ka lëshuar urdhrin përmbareimor P.nr.67/2021 të datës 22.01.2021, me të cilin ka lejuar përmbareimin, në bazë të ekstraktit të verifikuar nga librat afarist të kontabilitetit me shifër 91286, duke e obliguar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri t'i paguaj kreditorit borxhin prej 1,538.86 €, si dhe shpenzimet e përmbareimit sipas tarifës së përmbareuesve privat në pajtim me Udhëzimin Administrativ UA-MD Nr.06/2014 për Tarifat, Shpërblimet dhe Kompensimin e Shpenzimeve për Përmbareuesit Privat, nën kërcënim të përmbareimit të dhunshëm, me ndalimin e mjeteve në para të cilat i ka debitori në xhirollogarinë e tij bankare, dhe bartjen e shumës përkatëse në xhirollogarinë bankare të kreditorit, ose me konfiskimin dhe shitjen publike të sendeve të luajtshme të debitorit dhe bartjen e atyre mjeteve në xhirollogarinë e kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbartimor, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Më tutje ka deklaruar se kërkesa e kreditorit është parashkuar në kuptim të nenit 360 të Ligjit Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (tutje LMD). Gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj prapësimin e debitorit si të pabazuar dhe ta anuloj urdhrin përmbartimor në tërësi.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar prapësimin e debitorit, ku ndër të tjerash ka deklaruar se propozimit i ka bashkëngjitur si provë kartelën financiare të lartcekur me të cilën argumentohet se debitori ka pranuar furnizimin me ujë të pijes. Në lidhje me deklaratimet e debitorit lidhur me parashkrimin të njëjtat i ka kundërshtuar, për faktin se debitori ka pranuar borxhin dhe njëkohësisht ka bërë pagesa të pjesshme, me anë të së cilës është ndërprerë parashkrimi sipas nenit 368 të LMD-së. Ka theksuar se debitorit i kanë dërguar shtatë vërejtje me shkrim lidhur me krijimin e borxhit, por që deri më tani e njëjta nuk e ka kryer obligimin. I ka propozuar gjykatës që ta hedhë poshtë prapësimin e debitorit si të pabazuar dhe njëkohësisht të obligohet debitori që të kryej obligimin e tij.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike lidhur me këtë çështje përmbartimore me Aktvendimin KPPP.nr.171/2023 të datës 24.07.2024, ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit dhe ka shfuqizuar urdhrin përmbartimor P.nr.67/2021 të datës 22.01.2021 të përmbartuesit privat Arsim Bajraktari.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë, me Aktvendimin Kom.Dh.Shk.II.nr.1147/2023 të datës 13.02.2024, ka aprovuar si të bazuar ankesën e kreditorit dhe ka prishur aktvendimin KPPP.nr.171/2023 të datës 24.07.2024, të Gjykatës Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike dhe kjo çështje të njëjtës gjykatë i është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, vërejtjeve sipas aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë, dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm - Ekstrakti i verifikuar nga librat afarist Nr. 91286, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbardim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbardimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa në par.1 nën par. 1.2 të po këtij neni, si dokument i besueshëm sipas ligjit konsiderohen: *“ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”*, ndërsa me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbardim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Në rastin konkret pavarësisht faktit se propozimi për përmbardim është lejuar sipas Ekstraktit nga librat e kontabilitetit - Kartela Financiare e Konsumatorit në kuadër të Kompanisë Rajonale Ujësjetllësi “Prishtina” Sh. A, gjykata gjen se dokumenti mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbardim, e mbi bazën e të cilit përmbarduesi privat ka lejuar përmbardimin, nuk i plotëson kushtet që të konsiderohet dokument i besueshëm, për shkak që nuk i përmban tiparet e një ekstrakti nga librat afarist, meqenëse në këtë dokument nuk janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, si dhe nuk mund të konstatohet se për cilat periudha kohore është kërkuar përmbushja e borxhit nga debitori.

Gjykata deri te ky vlerësim erdhi pasi që nga ekstrakti afarist i bashkëngjitur sipas shifrës 91286, rezulton se borxhi në shumën prej 1,538.86 €, është kërkuar për periudhën kohore nga data 01.01.2013 deri me datën 19.01.2021, ndërsa në përmbajtjen e këtij ekstrakti, nuk është përfshirë fare periudha prej datës 01.01.2013 deri me datën 30.12.2013 dhe nuk mund të vërtetohet se si ka ardhur deri tek borxhi i kërkuar, andaj si rrjedhojë ky dokument nuk pasqyron qartë detyrimin që rrjedh nga i njëjti dhe nuk përmban atributet e një dokumenti të besueshëm.

Andaj pasi që gjykata vlerësoi se dokumenti në bazë të së cilit është lejuar urdhri përmbardimor në rastin konkret, nuk i ka tiparet e dokumentit të besueshëm si dhe nuk ka tipare të përmbardueshmërisë, si rrjedhojë nuk i shqyrtoi fare pretendimet tjera të palëve ndërgjyqëse lidhur me parashkrimin e kërkesës.

Gjykata në kuptim të nenit 71 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.334/24, datë 28.06.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.